



C.nr.337/14

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED], tani me adresë të panjohur të vendbanimit, të cilin e përfaqëson në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaj, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë me datë 23.10.2017, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadija e paditësit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] dhe vërtetohet se paditësi [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale 00522-0, Zona Kadastrale Neredime e Poshtme, me sipërfaqe prej 2715 m².

II. Detyrohet paditësi [REDACTED] që kësaj Gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi të ia paguaj shumën e të hollave prej 30 euro.

Arsyetim

Paditësi [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] ka parashtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] tani me adresë të panjohur të vendbanimit, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë.

Paditësi gjatë shqyrtimit kryesorë ka theksuar: në vitin 1986 nga [REDACTED] e kam blerë paluejtshmërinë kontestuese për qmimin prej 300 marka arin, të cilin qmim i'a kam paguar në tërësi të paditurit, kurse i padituri [REDACTED], ma ka dorëzuar në posedim paluejtshmërinë kontestuese, të cilën unë e shfrytëzoj pa u penguar nga askush nga viti 1986 e deri në ditën e sotme 2017, në atë mënyrë që në të njëjtën tokë kam bërë kultivimin e kulturave bujqësore, misër, grurë, pasul, po ashtu kemi mbjedhur domate një vit po, një vit jo.

Paditësi ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se paditësi [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale 00522-0, Zona Kadastrale [REDACTED], me sipërfaqe prej 2715 m².

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. [REDACTED] nga Ferizaji ka theksuar: nga provat e nxjerra nga ana e kësaj gjykate vërtetohet se paditësi në vitin 1986 ka hyrë në shitblerje të paluejtshmërisë kontestuese, ashtu që paditësi i'a ka paguar të paditurit qmimin e shitblerjes së paluejtshmërisë në fjalë. Këtë fakt e vërtetuan dëshmitarët, deklaratat e të cilëve nuk ishin kontradiktore me njëra tjetrën si dhe të njëjtat ishin në përputhje me deklaratën e paditësit në



. Kurse faktin se paditësi tokën kontestuese e shfrytëzon pa u penuar nga askush nga viti 1986 e deri tani gjykata e ka vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED]

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e nenit 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj .

Vendimi për shtesën e taksën gjyqësore për padi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :23.10.2017

Gjyqtari

Burim Emërllahu



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

